
AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALB PRO SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALB PRO” SHPK

KREU I

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ALB PRO” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

NENI 2

SELIA

- 2.1.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Preze AHMETAQ Km i parë pas kthesës së Rinasit, perballë Fabrikes së Polisterolit, Zona Kadastrale nr 1006. Nr. pasurie 105/52, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- 4.1 Veprimtari në fushën e ndertimit, prodhim, montim të cdo lloj qofshin civile, industriale apo bujqësore, ndertim linja elektrike, hidraulike, ujesjellesa, kanalizime, rruge, prita, ura, tunele, vepra arti e restaurime. Në fushën e studimit, projektimit, ndertimit e shfrytëzimit të objekteve civile, industriale, bujqësore, HeC-ve, gurorë, gjithë llojeve të materialve të ndertimit si inerte, betoni, parafabrikate të ndryshme dhe konstruksion e tubacione metalike të të gjitha llojeve etj. Kryerja e cdo lloj operacioni dhe transaksioni në lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme ushqimore, industriale, bujqësore e blegtorale. Veprimtarin e shkëmbimeve valutore, transfertave dhe postave brenda dhe jashtë vendit. Ruajtje transport dhe përdorim të lendeve plasese në Shqipëri dhe jashtë saj. Transport mallrash e udhëtarësh me mjete rrugore, detare dhe ajrore brenda dhe jashtë vendit. Infrastruktura, ujesjellesa, kanalizime, vepra pastrimi të ujit të pijshëm, vepra pastrimi të ujërave të zeza. Ndertim hidrocentralesh, ndertim dhe instalime fotovoltmetrike. Ndertim i veprave të restaurimit dhe I rikonstruksionit të tyre. Ndertime në det. Punime të mbrojtjes lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime. Punime kundër zhurmës në infrastrukture. Punime kundër zhurmës për



ndertime social kulturore. Punime gjeologjikeinxhinierike. Punime te perpunimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Punime te strukturave speciale. Punime per prishjen e ndertimeve. Punime te inxhinierise se mjedisit. Ndertime per nenstacionet, kabinave e transformatoreve, linjat e nenstacionit te mesem per energjine.Mirmbajtje me performance e rrugeve. Tregti me pakice te artikujve higjenosanitare, elektrike, hidraulike, materiale ndertimi dhe artikuj te ndryshem.Tregtim mepakice dhe shumice te gomave te reja, bated, produkteve industrial, makina te perdorura dhe pjese kembimi. Tregtim e montim, duralumini, punime druri dhe plastike, punime etalbont, fasada xhami etj. Lyerje te te gjitha llojeve. Pastrim dhe mirembajtje pyjesh, kullotash, mbjellje pemesh, dru frutore, peme dekoratike, peme te ndryshme pyjore. Ndertim dhe rikonstruksione te ndryshme. Pllaka dhe pajisje hidraulike, hidrosanitare e termosanitare. Mallra industriale te lendeve te para e materialeve te ndertimit. Tregtim dhe montim kondicioneresh. Veshje fasadash,punime bojatisje, hidroizolime, termoizolime,akustike dhe kunder zjarrit te impjanteve teknologjike, mirembajtje dhe dekori ne mjedise urbane. Tregtim materiale ndertimi, inerte, rere, mermer,bazalt etj. Ndertimin e rrjeteve inxhinierike. Import-eksport. Panele diellore.

- 4.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.
- 4.3 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë. Kapital i Shoqërisë nënshkruhet dhe paguhet tërësisht nga ortaku;

- **HAMIT HOXHA**, shtetas shqiptar, lindur më 01.06.1983, identifikuar me ID me numer personal I30601278V, zotëron 1 (një) kuotë pjesëmarrje, me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqind mijë) Lekë; që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

- 6.1 Kuotat e shoqërisë mund tu transferohen lirisht të tretëve në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.



NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Kapitali i shoqërisë mund të rritet në çdo kohë me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 8

ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

KREU III

ASAMBLEJA E PAERGJITHSHME

NENI 9

ASAMBLEJA E PAERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimtarës i shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje të ortakëve të shoqërisë, dhe vecanërisht mbi vijueset:
- a. ndryshimin e këtij Statuti;
 - b. zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë;
 - c. emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar;
 - d. miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar;
 - e. shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë;
 - f. emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Shoqërisë.
- 9.2 Vendimet e Ortakut të Shoqërisë duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.



NENI 10

FINANCIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejte të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 10.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto фонде.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 11.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga ortaku i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Ortaku i shoqërisë ka të drejtë të emërojë, apo pushojnë në çdo kohë Administratorin.
- 11.2 Si Administrator i Shoqërisë emërohet:
- **Z. HAMIT HOXHA**, shtetas shqiptar, 01.06.1983, identifikuar me ID me numer personal I30601278V, banues në adresën: Rr. Ismail Qemali, Paskuqan, Tiranë, Shqipëri.
- 11.3 Administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 11.4 Administratori vepron në përputhje me politikat e biznesit të përcaktuara nga Ortakët e Shoqërisë. Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakëve të Shoqërisë apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 11.5 Administratori është përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori mund t'ua delegojë palëve të treta tagrat e lidhura me administrimin e Shoqërisë. Administratori mbetet përgjegjës i drejtpërdrejtë për të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit në lidhje me administrimin e Shoqërisë.
- 11.6 Administratori do të veprojë gjatë gjithë kohës në interes të Shoqërisë. Në rast të një konflikti interesi, Administratori do të informojë menjëherë Ortakët e Shoqërisë, dhe nuk do të kryejë asnjë veprim lidhur me çështjen objekt i konfliktit të interesit, deri në pajisjen me udhëzimet përkatëse nga Ortakët e Shoqërisë.

NENI 12

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORËVE

- 12..1 Ortaket e Shoqërisë përcaktojnë shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU V

KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË

VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 13

KONTROLI KONTABËL

- 13.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët e Shoqërisë do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 14

VITI FINANCIAR

- 14.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 15

BILANCI VJETOR DHE REZERVAT

- 15.1 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Ortaku i Shoqërisë të vendosi mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 15.2 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventarët, raportet e Administratorit dhe Ekspertit Kontabël miratohen nga ortaku i Shoqërisë. Administratori i paraqet Ortaku të Shoqërisë për miratim, raportin mbi administrimin e Shoqërisë si dhe pasqyrat financiare vjetore.
- 15.3 Ortaku i Shoqërisë vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 15.4 Ortakët e Shoqërisë në çdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.



KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 16
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 16.1 Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 17
NJOFTIMET

- 17.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 17.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 17.3 Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU VII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 18
LIGJI I ZBATUESHEM

- 18.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e këtij Akti Themelimi, Statuti dhe legjislacionit shqiptar. Për të gjitha ato çështjet që nuk janë parashikuar në këtë dokument, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar mbi shoqëritë tregtare.

NENI 19
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 19.1 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve të saj, ose ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të tyre, dhe/ose Shoqërisë, lidhur me interpretimin dhe / ose zbatimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë.



NENI 20

GJUHA

20.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut përpilohet ne 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU:

HAMIT HOXHA Hamit Hoxha



Tiranë, më 01/04/2023



Qendra Kombetare e Biznesit
National Business Center (/)



(/)



(/home/)

Kërkoni



Menu

Kërko për emër të lirë

ALB PRO

Kërko

Pastro

Emër i Lirë



© 2023 QKB ALL RIGHTS RESERVED

(<https://www.facebook.com/QKB-Qendra-Komb%C3%ABtare-e-Biznesit-970340259660116/>)

(<https://twitter.com/qkb2016>)

